



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5726 Prot.

Roskovec, më 29, 08 2021

VENDIM
NR. 10 .DATË 23 .08 .2021

“PËR ANULIM TË VENDIMIT NR.17 DATË 19.02.2019 “PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË ROSKOVEC PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË LIDHJES SË KONTRATËS SË SHIT-BLERJES”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2; të kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 41, neni 109, gërma “d”, neni 113 dhe neni 117; Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar; të Vendimit nr. 69, datë 10.08.2021 të Kryetarit të Bashkisë Roskovec “Për fillimin e procedurës administrative, për anulimin e aktit administrativ/vendim të Këshillit Bashkiak nr.17 datë 19.02.2019”; procesverbalit nr. 5514/1 prot, datë 10.08.2021; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Anullimin e VKB nr. 17 datë 19.02.2019 “Për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për kryerjen e procedurave të lidhjes së kontratës së shit-blerjes”, pasi bie në kundërshtim me ligjin material nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.
- 2- Ngarkohet Njësia Përgjegjëse për zhvillimin e procedurës administrative, për kryerjen e procedurave të mëtejshme dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

**KRYETAR
Kadri Hyska**

